

**NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. _____ (Aksionar/Përfaqësues/e i/aksionarit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Merkurë datë 16 Prill 2025 ora 11:00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Mbi miratimin e transferimit nepermjet shitjes së kuotave të zotëruara nga Banka Credins sh.a. në Shoqërite Komandite SIK "Sea Land Alternative Investment Fund", dhe "Green View Alternative Investment Fund".
2. Autorizohet Drejtoria e Banka Credins sh.a. te perfaqesoje interesin me te mire te Bankes ne kete transaksion, duke patur të drejten per të percaktuar permbajtjen e transaksionit dhe/ose kontrates perkatese dhe formes së saj, çmimit dhe menyres së aplikimit dhe permbushjes, si dhe çdo detaj apo kush tjetër të rastit, të pergjithshem apo të diktuar nga nevojat e faktit apo ligjit, si dhe te ndermarre te gjitha hapat dhe procedurat e nevojshme ligjore (perfshire caktimin e konsulenteve ligjore), administrative dhe operacionale, perfrishire negociimin me palen blerëse dhe eventualisht nenshkrimin e marreveshjes se shitjes se kuotave, dhe cdo dokument tjetër te nevojshem ne funksion te ketij transaksioni.
3. Autorizohet dhe ka të drejte vote, perfaqesimi dhe nenshkrimi Drejtori i Pergjithshem në kuader të vendim-marrjes së Asambleve të Pergjithshme të shoqerive komandite SIK "Sea Land Alternative Investment Fund", dhe "Green View Alternative Investment Fund", per llogari të Banka Credins.
4. Drejtoria e Bankes Credins autorizohet dhe ka edhe çdo tager tjetër të pashprehur, por te implikuar dhe nga rrethanat dhe nevojat proceduriale ligjore, per të vepruar në çdo rrethane dhe per të realizuar çdo transaksion apo veprim tjetër, me qellim kompletimin dhe perfundimin e objektit te autorizimit (pershkruar në piken 1 më lart).

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tiranë më 26.03.2025

NUIS K316088010
Swift CDISALTR

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionarët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:
 - a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».
- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.
- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.
- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.
- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.
- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.
- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Kopje të dokumenteve dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.